



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:255037

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753462

KE.nr.861/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Shtetërore, kundër të paditurit Komuna Lepasaviq, me seli në Lepasaviq, me objekt kontesti Pasurim i pabazë, jashtë seancës me datën 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE, për të vendosur sipas padisë së paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me numër të lëndës KE.nr.861/22 të datës 14.06.2019, kundër të paditurit Komuna Lepasaviq, me objekt kontesti pasurim i pabazë.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 14.06.2019, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi kundër të paditurit Komuna Lepasaviq, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit ashtu që të detyrohet i padituri që paditësit t'ia paguaj shumën e mjeteve prej 850,000.00 €, në emër të pasurimit të pabazë.

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë si dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Sipas nenit 2 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale është përcaktuar shprehimisht se: *“Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë, vendorë dhe të huaj përfshirë shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës të cilët kanë konteste tregtare ndërmjet tyre”*, ndërsa sipas nenit 3, pika 1.11, kontesti tregtar është definuar si: *“çdo kontest mes shoqërive tregtare, shoqërive tregtare dhe subjekteve publike dhe të gjitha konflikteve administrative të shoqërisë tregtare, siç përcaktohet në nenin 13 të këtij Ligji”*. Në anën tjetër, me nenin 13, paragrafi 1, pika 1.1 të të njëjtit ligj, përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*.

Meqenëse në rastin konkret çështja juridike zhvillohet në mes të paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të paditurit Komuna Leposaviq, që të dyja institucione publike, ndërsa sipas dispozitave të cituara më lartë Gjykata Komerciale është e kompetencës lëndore për të gjykuar çështjet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate, ngase asnjëra nga palët nuk e ka cilësinë e shoqërisë tregtare dhe rrjedhimisht kjo çështje nuk përfaqëson çështje tregtare për vendosjen e së cilës do të ishte e kompetencës kjo gjykatë, dhe duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.861/22, datë 29.05.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate